

## **Hapet thirrja për aplikime për Stafin Akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Charles, në Çeki, në Kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Charles, në Çeki për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Stafi akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

### **Fushat e studimit:**

- Studime Evropiane;
- Shkenca Politike;
- Histori;

<https://krvseng.fsv.cuni.cz/>

<https://www.cuni.cz/UKEN-1.html>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| <b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b><br>( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> ) | <b>Kompensimi</b> |
|--|-------------------|
| <b>Midis 100 dhe 499 KM</b>  | 180 EUR           |
| <b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>   | 275 EUR           |
| <b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>  | 360 EUR           |
| <b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>  | 530 EUR           |
| <b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>  | 820 EUR           |
| <b>8000 KM ose më shumë</b>  | 1100 EUR          |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **➤ Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf)

\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

### **Afati për aplikime për bursa: 07 Janar 2019**

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!